

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.F.nga P., rruga "...” nr...., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.6446/13 të datës 21.11.2013, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit-Armend Hamiti, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarve av. A. Q., të dëmtuarve, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. M. H., me datë 17.03.2014 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari S.F.**, i biri i K. dhe nënës H. e vajzërisë A., i lindur më *data e lindjes...*, në P., me vendbanim në P. rruga "...” nr. ..., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në SHPK zyrtar policor, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i gjykuar me dënim me gjobë, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në paraburgim nga data 26.09.2013 e këndej.**

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### Sepse:

Me datë 19.09.2013, rreth orës 16:23, në rrugën rajonale Podujevë – Kërpimeh, në fshatin P., përballë shtëpisë së I. H., i pandehuri S.F., derisa ka qenë duke e drejtuar automjetin zyrtarë të Policisë së Kosovës të tipit “Toyota Land Cruiser J15 TM”, me ngjyrë hiri metalike, me targa të regjistrimit “Police-...-...”, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 54 par. 1 dhe nenin 71 par. 1 të Ligjit për Siguri në Komunikacion Rrugor, nuk ia ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes automjetit kushteve në rrugë, ka drejtuar automjetin me shpejtësi rreth 97 km/h dhe pa u bindur mire se me një veprim të tillë nuk i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit të një automjeti dhe traktorit të cilët qarkullonin para tij, ka dalë në shiritin e kahjes së kundërt, dhe i njëjti në pamundësi të rimarrjes së shiritit të tij paraprak të lëvizjes dhe realizimit të plotë të tejkalimit, me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit të tij e godet në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin e tipit “VW Golf HXO” me ngjyrë të kaltër metalike, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, të cilin e drejtonte tani i ndjeri S.H., i cili ishte duke qarkulluar në shiritin e tij, nga drejtimi i fshatit B. në drejtim të Podujevës, ku i njëjti nga goditja që pëson ndalet në afërsi të pozicionit të goditjes duke pësuar rrotacion rreth aksit vertikal për një kënd rreth 140 shkallë, i kthyer me pjesën e përparme pranë vijës ndarëse të drejtimit të lëvizjes, ndërsa automjeti të cilin e drejtonte i pandehuri, nga goditja vazhdon lëvizjen në mënyrë të pakontrolluar duke pësuar rrotacion ndaj aksit vertikal, del jashtë rrugës, në anën e djathtë dhe ndalet në pozicionin prej rreth 11 metrave, me ç’rast nga plagët e marra pas disa çasteve

ndërrojnë jetë të ndjerët S. dhe M. H., si dhe lëndime të rënda trupore pësojnë të dëmtuarit F. H., S. H. dhe S. A., ndërsa të dëmtuarit A. G. dhe A. Q. pësojnë lëndime të lehta trupore, si dhe janë shkakuar dëme të mëdha materiale në të dy automjetet e përfshira në aksident.

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4,17,23,41,42,43,45,62,68,73,83,dhe neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neni 365 të KPPRK-së, e

## **G J Y K O N**

Të akuzuarin S.(K.) F., i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) vitesh** të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Konform neni 83 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 26.09.2013, e këndej.

Pas shpalljes së aktgjykimit të akuzuarit në kuptim të neni 367 par. 2 të KPPRK-së, me aktvendim të posaçëm i vazhdohet paraburgimi deri sa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit, F. H., S. H. me familje nga fshati B., Komuna e P., S. A. nga P. rr.”...”pn, A. G. nga fshati D., Komuna e P., dhe A.Q.nga fshati B., Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 969.80 Euro (për ekspertizë të komunikacionit, ekspertiza mjeko-ligjore dhe ekspertizë mbi ekzaminimin e automjeteve), kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 300€ (treqind/euro), brenda afatit prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Ndaj të akuzuarit kjo gjykatë në bazë të neni 62 dhe 68 par.1, 2 ,3 dhe 4 të KPRK-së, i shqipton edhe:

## **DËNIM PLOTËSUES**

Marrjen e lejes së vozitjes-patent shoferin të kategorisë “B” me numër serik DL ..... dhe i ndalohet marrja e lejes së re gjatë periudhës prej tre (3) viteve, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë. Koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit plotësues, pas skadimit të afatit të caktuar nga gjykata, kryesi mund të marrë lejen e re të vozitjes sipas kushteve të përgjithshme të parapara për marrjen e lejes përkatëse të vozitjes.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.6446/13 të datës 21.11.2013, kundër të akuzuarit S.F. për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata mbajti shqyrtimet gjyqësore me datë 25.11.2013, 30.12.2013, 13.02.2014, 26.02.2014, 10.03.2014, 17.03.2014 në praninë e prokurorit të Shtetit, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarve, të dëmtuarve, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit i akuzuari u deklarua i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Pas të gjitha seancave gjyqësore të këtij procesi në tërësi është vërtetuar dyshimi mirë i bazuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë ngase i akuzuari ditën kritike me dt.19.09.2013 rreth orës 16:23, në rrugën rajonale Podujevë - Kërpimëh, saktësisht në fshatin Peran përball shtëpisë së I.H., ishte duke e drejtuar automjetin zyrtar të tipit “Toyota Land Cruiser” me targa “Police-...-..”, i njëjti nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon jetën e njerëzve dhe kjo rezultojë me vdekje – se çka ndikoi në këtë pakujdesi u sqarua nga vet mbrojtja e dhënë nga i akuzuari se atë ditë kishte ndodhë vrasja e policit të Eulexit në veri të Kosovës dhe ai dhe njësitë i tij kanë kryer detyrën e përcaktuar në planin operativ për zgjidhjen e këtij rasti, dhe pasi që të gjithë ishin të lodhur e koha ishte me shi dhe të nesërmen i akuzuari kishte detyra tjera, ku ai me automjetin zyrtar filloi t’i shpërndaj kolegët nëpër shtëpia dhe si rezultat i kësaj lodhje ka ardhur tek pakujdesia e cila ishte brenda disa sekondash, por rezultojë me fatalitet. Se i akuzuari nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë u vërtetua me metoda shkencore nga komisioni i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike-Departamenti i Komunikacionit në Prishtinë në përbërje prof. Dr. N. I., Mr.sc. M. B. dhe Msc. G. H. të dt.18.10.2013 të cilët kanë dhënë përfundimin se i akuzuari ishte duke lëvizur me shpejtësi 97 km/h po ashtu se ishte shpejtë u theksua edhe nga dëshmitaret dhe se kjo tregon se veprimet e të akuzuarit ishin në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR, se ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit të një automjeti dhe traktori duke dal në shiritin e kahjes së kundërt dhe në pamundësi të rimarrjes së shiritit të tij paraprak dhe të kryerjes së tejkalimit me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit të tij ka goditur në pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit “VW Golf” të cilën e drejtonte tani i ndjeri S.H., kjo vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarëve-dëmtuarve F. H., S. A., dëshmitarëve A. Sh., F. Sh., Xh. F., L. F. si dhe nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar me shkrim nga komisioni i ekspertëve të dt.18.10.2013, si dhe shpjegimet e eksperteve në seancë dhe paraqitjes së CD (video-incizim) ku duke u bazuar nga raporti policor me foto dokumentacionin dhe skicën e vendit të ngjarjes nga pozicioni se si kanë mbetur automjetet e aksidentuara, u gjet pika e saktë e goditjes së automjeteve, e cila pikë ishte në shiritin e automjetit Golf, dhe po ashtu ka shtuar se veprimet e të akuzuarit ishin në kundërshtim me nenin 71.1 të LSKRR, është fakt i pamohueshëm se si rezultat i këtij aksidenti kanë vdekur S.H. dhe M.H. e nga raporti i autopsisë së ekspertit mjeko ligjor Dr. M. G., i datës 20.09.2013, vërtetohet fakti se të ndjerët kanë vdekur si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit të shkaktuar nga i akuzuari. Lëndime të rënda trupore nga ky aksident pësuan S. H., F.H., S.A. kurse lëndime të lehta trupore pësuan A.Ç.dhe A. G. nga raporti i ekspertizës mjekoligjore nga eksperti mjeko ligjor Dr. N.U., i datës 11.11.2013, dhe kërkoj nga gjykata që pasi ti vlerësoj rrethanat rënduese dhe lehtësuese të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas Kodit, gjithashtu në pajtim me nenin 62 par.2 pika 2.5 të KPRK-së ti shqiptoj edhe dënimin plotësues marrjen e lejes së vozitjes.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarve F.H., S.H. dhe S.A. fjalën përfundimtare e ka deponuar me shkrim dhe e ka elaboruar shkurtimisht i cili ka deklaruar: Ajo që ndodhi me 19 shtator

2013, me ç ‘rast dy djemtë e familjes H., S. dhe M. H. vdiqën tragjikisht dhe pjesëtarët tjerë të familjes u lënduan rënd, sigurisht se nuk ishte veprë e qëllimshme apo e dëshiruar nga palët e involvuara, mirëpo kjo megjithatë nuk e përjashton nga përgjegjësia penale përgjegjësia e cili ndërmoi veprimin e tejkalimit në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e sigurisë së komunikacionit. Nga deklaratat e dëshmitareve dhe ekzaminimet e ekspertëve gjatë shqyrtimit gjyqësor është dëshmuar përtej çdo dyshimi të bazuar se i pandehuri shkaktoi aksidentin gjatë tejkalimit të tij të kundërligjshëm. Pra, një fakt i tillë dëshmohet nga përputhshmëria e deklaratave të dëshmitarëve dhe ekspertiza profesionale nga ekspertët e komunikacionit të cilët edhe në këtë sallë të gjykimit demonstrojnë metodat shkencore të cilat ata i kanë përdorur për të arritur përfundimet. Prandaj, ekspertiza e ekspertëve dhe dëshmitë e dëshmitarëve nuk lënë hapësirë dyshimit në lidhje me atë se kush është përgjegjës në lidhje me aksidentin. Pasojat e veprës penale për të pandehurin në çdo rrethanë janë të pa riparueshme, asgjë më nuk mund të kthejë në jetë apo të kompensojë jetën e dy djemve të tyre dhe asgjë më nuk mund të ja kthejë atyre në jetë shëndetin e plotë. Konsiderojmë se i pandehuri duhet të marrë dënimin sipas KPRK-së, i cili dënim duhet patjetër të reflektoj peshën e veprës penale dhe pasojat e saj si dhe të marr për bazë faktin se i pandehuri është zyrtar policor dhe përgjegjësia mbi të bie më shumë se sa në një qytetar të zakonshëm dhe ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike gjatë procedurës penale.

Ndërsa të dëmtuarit-dëshmitarët A. G.dhe A.Ç. të cilët nuk kanë prezantuar në shqyrtimin gjyqësor të dt.17.03.2014 për të dhënë fjalën përfundimtare lidhur me kërkesën pasurore-juridike edhe pse të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, udhëzohen për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit fjalën përfundimtare e ka deponuar me shkrim dhe ka deklaruar: Me aktakuzën e Prokurorisë Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë, të pandehurin S.F. nga Podujeva pjesëtar i policisë së Kosovës i vihet në barrë vepra penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 lidhur me par 6 dhe 1 të KPK, nga pakujdesia me shkelje të nenit 54 par 1 dhe neni 71 par 1 të ligjit për siguri në komunikacion Publik. Aktakuza është nxjerr në bazë të dëshmive të dëshmitarëve okular të ngjarjes si dhe nga ekspertiza e komunikacionit. Ajo që vërejmë në këtë çështje është se dëshmitarët kanë përshkruar atë që kanë parë nga këndet e ndryshme, këndi i parë dëshmitarët që ishin në kamionet dhe qarkullonin pas veturës Golf 3, këndi i dytë i traktoristit, këndi i tretë i bashkudhëtarëve të pandehurit dhe këndi i katërt i bashkudhëtarëve të veturës Golf 3. Dëshmitari A.Sh., F.Sh., Xh. F., L. F., A.G., A. Ç., dëshmitarët F.H. dhe S.A. ka theksuar se këta dëshmitar secili nga këndi i vet i vështrimit u përpoqën të paraqesin në kuadër të potencialit të tyre të kujtesës atë që e kishin parë. Por kundërthëniet të cilat i vërejmë na bëjnë të bindemi edhe njëherë se dëshmitarët janë prova më e pa sigurt në procedurë. Mbrojtjen e të pandehurit S. duhet të vlerësojmë si tejet të sinqertë dhe në kuadër të kapacitetit të tij për ti rikujtuar sekuencat se si erdhi deri te kjo tragjedi. Atij i kujtohet fakti se në momentin kur u shkaktua aksidenti ndodhej në krahun e vet të lëvizjes, se nuk ishte në shpejtësi të madhe të qarkullimit sepse duhej të ndalej afër marketit “A. P.” i cili fakt është vërtetuar nga dëshmitari A.G.. Ekspertiza e përpiluar nga tre (3) ekspert të cilët u përpoqën të japin sqarimet e tyre në dy shqyrtimet gjyqësore nuk arritën që të zgjedhin çështjet qendrore, të përcaktojnë piken e kontaktit fizik në mes të dy automjeteve, për shkak të mungesës së njohurive të tyre profesionale, kjo rezulton më së miri se eksperti Prof.dr. N. I. ka doktoruar në lëmin e makinerisë e jo për atë të komunikacionit. Ekspertët gjatë tërë kohës u sollën nga një rreth vicioz nga i cili asnjëherë nuk arritën të gjejnë shtegun dhe të na tregojnë me saktësi se ne cilën anë ndodhi aksidenti, për këtë edhe propozuam që t ‘na epet kohë për ekspertizë të re që konsiderojmë se padrejtësisht dhe në mënyrë të kundër ligjshme na është refuzuar nga gjykata. Kërkoj nga gjykata që edhe njëherë të rishqyrtohet propozimi që të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes, si dhe kërkoj nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit të dënimit, që të ketë

parasysh rrethanën se edhe në veprimet e tani të ndjerit kishte lëshime siç janë : vozitja mu në afërsi të vijës ndarëse të korsisë, shpejtësia e qarkullimit prej 84 km/h, se edhe të pandehurit i janë shkaktuar plage serioze trupore e në veçanti i janë shkaktuar plagë të rënda psikike të cilat do ta përcjellin gjerë në fund të jetës së tij, si dhe keq ardhjen e thellë për tragjedinë e ndodhur të cilën ai nuk e deshi, po ashtu luteni që të vlerësohet si rrethanë lehtësuese faktin e qëndrimit të tij korrekt para gjykatës, se është i pa gjykuar për vepra të tilla, se është baba i dy fëmijëve të mitur dhe ushqyes i vetëm i tyre, ti shqiptoni një dënim sa më të butë në të cilin do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i shqiptimit të sanksioneve penale, njëkohësisht kërkoj që ndaj të pandehurit ti ndërpritet masa e paraburgimit.

I akuzuari në mbrojtjen e tij i cili nuk e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare veç tjerash deklaroi: Ditën kritike kam qenë duke punuar në sektorin e hetimeve të drejtorisë rajonale të policisë kufitare në fshatin Lluzhan, pasi që kishte ndodhur një vrasje e një polici Lituanes të Eulex-it në pjesën veriore të Mitrovicës, ishim të gjithë të angazhuar në një plan operativ. Pasi ka përfunduar plani operativ dhe në përfundimin e orarit të punës i gjithë stafi ishte i lodhur atë ditë gjatë angazhimit të planit, Zv. Drejtori I. M. më tha pasi që ishte duke rënë shi t'i dërgoj dy kolegët A. G. dhe A.Ç. deri në fshatin Dobërdol për arsye që ishte urdhër se nesër në ora 5 të mëngjesit me u zgjua unë të vij në stacion policor, ta marr automjetin e policisë të shkoj të marr I. M. për të shkuar në Mitrovicë për ta zbatuar planin operativ. Jam nisur nga stacioni policor në Lluzhan-Drejtorinë, për në drejtim të Podujevës, kemi vazhduar përmes rrugës “...” në drejtim të fshatit Kërpimëh, gjatë vozitjes kushtet e rrugës kanë qenë me shi, para se të ndodh aksidenti e kam parë larg një kamion ne anën e kundërt, ndërsa para meje e kam pasur një Golf 4 ngjyrë e zezë e cila ka qenë larg meje në largësi prej 20-30 m dhe nuk kam tentuar të tejkaloj, i njëjti ka shtuar se pasi që i kemi kaluar pengesat e kam tejkaluar një traktor në rrugë të drejt dhe pasi që e kam tejkaluar traktorin e di që jam rreshtuar në trasenë dhe rreth 30-40 m ka ndodhur aksidenti, për afërsisht rreth 1 km e gjysmë prej udhëkryqit në dalje të Podujevës ka ndodhur aksidenti, nuk më kujtohet fare Golfi 3. Gjatë rrugëtimit kam zhvilluar shpejtësinë brenda perimetrit të normales, po ndoshta edhe e kam tejkaluar shpejtësinë dhe asaj rruge kam vozitur çdo dhjetë (10) ditë dhe e di se shpejtësia e lejuar është 80 km/h. Ndër të tjera në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij dhe i ka kërkuar falje familjes për humbjen e më të dashurve të tyre.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar të dëmtuarit-dëshmitarët: F.H., S.A., A.G., dhe A. Ç., dëshmitarët: A.Sh., F.Sh., M. Sh. dhe Sh. Sh., Xh. F., L. F., L.S. dhe D. B., si dhe janë dëgjuar ekspertët: Prof. Dr. N. I., Mr. M. B., Msc. G. H. dhe janë lexuar: ekspertizat mjekoligjore për pesë (5) të lënduarit të datës 11.11.2013, raportet e autopsisë për të ndjerit S. dhe M. H. të datës 19 dhe 20.09.2013, super ekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit të datës 18.10.2013, ekzaminimi i automjeteve të aksidentuara 10.10.2013, skicat dhe fotografitë e vendit të ngjarjes si dhe CD-në e incizuar mbi aksidentin e komunikacionit e propozuar nga grupi i ekspertëve, dhe mbrojtjen e të akuzuarit, të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plot dhe të drejt të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konfom nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Gjykata nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit F.H. ka vërtetuar, i cili veç tjerash ka deklaruar: Ditën kritike rreth orës 16:00 ishim në punë të zakonshme, kemi filluar rrugën për në drejtim të fshatit Peran, drejtuesi i veturës ishte djali, i ndjeri S., në ulësen e parë kam qenë ulur

kurse mbrapa ka qenë shoqja ime, djali M. dhe miku i djalit S.A. ka qenë mbrapa drejtuesit të automjetit dhe shpejtësia jonë ka qenë në suaza të normales, koha ka qenë e vranët ka rënë pak shi dhe rruga ka qenë pak e lagur. Në rrugën tonë nuk kemi pasur asnjë automjet lëvizës, ndërsa shiriti i kundërt drejtues ka pasur automjete, me që isha në ulësen e parë dhe pamja ishte e mjaftueshme nga drejtimi i kundërt kam vërejtur që ka hyrë një automjet në tejkalim të një automjeti tjetër në afërsi tonën, në anën e kundërt ka qenë një traktor me rimorkio me një ngarkues (kafshë) kështu që automjeti i cili filloi tejkalimin e atij automjeti në shirit të kundërt u mundua të gjej vend të rreshtohet pas atij traktori dhe në pamundësi për të rimarr - rreshtuar në shiritin e tij mundohet ta bëjë edhe tejkalimin e traktorit dhe në atë moment i kam bërëtitur djalit largohu se na mbyti! Shpejtësia ndoshta edhe e jona ka qenë e madhe, ndërsa shpejtësia e automjetit të kundërt i cili ka hyrë në tejkalim ka qenë marramendëse. E di që djali është munduar në atë moment të largohet nga shiriti ku kemi qenë duke e drejtuar automjetin dhe më kujtohet para krismës së automjetit që i ndjeri S. ka tentuar me lëshuar rrugën e të dal në trotuar, këtë e dëshmoi me atë se ishte një lloj pusët e vogël në trotuar dhe më kujtohet që na ka gjuajtur pika uji edhe pse nuk ka qenë e madhe dhe në atë moment e kam dëgjuar krismën kështu erdhi deri te goditja në shiritin tonë të lëvizjes.

Gjykata nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit S.A. ka vërtetuar, i cili veç tjerash ka deklaruar: Ditën kritike isha te motra në fshatin Bradash dhe jemi nisur për Podujevë me automjetin Golf 3 në të cilin ishim F., bashkëshortja e tij, djali i madh i ndjeri S.H. djali tjetër i ndjerë M. H. dhe unë isha i ulur mbrapa shoforit, koha ishte me shi por jo me të reshura të shumta, dhe prej që jemi dalë në rrugë magjistrale kemi qenë me një shpejtësi shumë të vogël rreth 40km/h dhe me të arritur në fshatin Peran e kam parë një veturë që ka dal nga tjetri shirit me shpejtësi shumë të madhe, dhe në atë moment para se të na goditë i ndjeri S.H. ka tentuar dhe ka dal nga shiriti ynë në anën e djathtë të trotuarit për t'ia lëshuar rrugën të akuzuarit, dhe ka theksuar se jashtë rruge ka pasur puqilla e që na kanë ra pika uji në xham, dhe në ato qaste e kemi dëgjuar krismën.

I dëmtuari-dëshmitari A. G. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Ditën kritike kemi pasur aktivitete të ngjeshura për shkak se është vrarë një zyrtar i policisë së Eulex-it në pjesën veriore të Mitrovicës, dhe unë si shef i sektorit kam qenë i obliguar të bëj vlerësimin e planit operativ, dhe ka shtuar se kur kemi arritur te minimarketi "A.-P." zakonisht fëmijëve ju marr gjëra ushqimore në atë market, jam kthyer për tu siguruar se a e kam kuletën në xhepin e prapmë të pantallonave për ti nxjerr disa të holla, më është dashur të kthehem shumë kujdesshëm për shkak se i kam dy operacione në boshtin kurrizor dhe në atë moment kam dëgjuar krismën. Ka theksuar se nuk e di sa ka qenë shpejtësia e automjetit me arsyetim se ka qenë i preokupuar me punët për ditën e nesërme dhe nuk e ka parë aksidentin si ka ndodhur e po ashtu nuk i kujtohet se a është tejkaluar ndonjë automjet para tyre.

I dëmtuari-dëshmitari A.Ç. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Ditën kritike ishim me automjetin "Toyota" së bashku me S.F. dhe A.G., dhe nuk më kujtohet si ka ndodhur aksidenti nga se kam qenë ulur mbrapa në anën e djathtë të automjetit, dhe ka shtuar se më kujtohet tejkalimi i një traktori dhe rreshtimi pas një automjeti "Golf 4" ndërsa nga krahu i kundërt kam vërejtur dy vetura njëra prej të cilave ka qenë kamionetë, dhe në momentin e goditjes kam dëgjuar kur kanë bërëtitur dhe më ka humbur vetëdija.

Gjykata nga deklarata e dëshmitarit A.Sh. ka vërtetuar, i cili veç tjerash ka deklaruar: Ditën kritike rreth orës 16:00, kemi qenë duke shkuar në një të pame në fshatin Ballofc me axhën M. Sh., me kushëri Sh. Sh. dhe N. Sh., dhe me djemtë e axhës Xh. Sh. dhe F.Sh., kemi qenë me një kamionet "Mercedes 208", unë kam qenë i ulur në mes të ulëses së prapme, gjatë rrugës kam parë kerrin Golf 3 ka qenë para neve, kam parë përpara kur ka ardhur xhipi i Policisë i cili ka ndërmarr veprim të tejkalimit të një veturë dhe ka dashur të rreshtohet në shiritin e vet, i njëjti nuk ka mundur dhe ka vazhduar edhe tejkalimin e traktorit dhe ka ardhur deri te aksidenti në rrugë – shirit të dëmtuarve, kur ka ndodhur aksidenti "Golfi 3" trapin e prapmë e ka ngrit dhe

është sjell komplet në kryq për 90 shkallë, dhe ka shtuar se unë kaloj asaj rruge përditë dhe nuk kaloj asnjëherë pa e shikuar atë vend ku ka ndodhur aksidenti dhe nuk kam parë asgjë që ka mbetur përveç përmendores të ndjerëve që ua kanë ngritur familjarët.

Gjykata nga deklarata e dëshmitarit F.Sh. ka vërtetuar, i cili veç tjerash ka deklaruar: Rreth orës 16:00 kam qenë duke ardhur në rrugën Bradash – Podujevë, dhe ka shtuar se prej bunarit të Bradashit e deri te aksidenti përafërsisht janë 2 kilometra, para makinës time ka qenë një automjet rreth 30 – 40 metra distancë, e kam parë një automjet që ka qenë në anën e kundërt duke ardhur e që ka hyrë në tejkalim me një shpejtësi shumë të madhe mbi 100 km/h, e ka tejkaluar një veturë dhe e ka pasur një traktor përpara që ka qenë me rimorkio, pa hyrë në shiritin e vet e ka goditur veturën “Golf” dhe për 1 m pjesën e prapme e ka qar lart duke e larguar nga toka dhe e ka sjell në pjesën gjysmë rreth.

Dëshmitari L. S. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Me datën 19.09.2013 kam qenë në shtëpinë time në fshatin Peran në katin e epërm në terasë e që është me xhama e rrethuar dhe e ka shikimin kah rruga, aty ku ka ndodhur aksidenti. Nga prokurori i shtetit iu lexua deklarata e dhënë në polici, ku i njëjti ka theksuar që një veturë e policisë ngjyrë hiri ka qenë duke shkuar në drejtim të fshatit Kërpimeh me një shpejtësi të madhe, kurse një veturë “Golf 3” me ngjyrë të kaltër e ka parë duke u sjellë në rrugë dhe i njëjti ka thënë se po ashtu është siç edhe e kam thënë në polici, mirëpo nuk jam në dijeni se sa ka qenë shpejtësia, ka shtuar se nuk kam parë ndonjë gjurmë që ka mbetur mbas aksidentit sepse i kanë hequr të gjitha.

Dëshmitari M. Sh. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: Ditën kritike kam qenë me djemtë e mi F. dhe Xh., nipin A., Sh. djali i kushëririt tim dhe N. Sh. kemi qenë duke shkuar një të pame dhe kur kemi dalë nga shtëpia për në rrugën Peran – Podujevë, konkretisht te shitorja “A.P.” kam qenë duke biseduar me kushëririn tim Sh. dhe ka bërë titur djali im F., “o bal pasha Zotin u mbytën!”, i njëjti ka theksuar se nuk e kam parë aksidentin.

Dëshmitari Sh. Sh. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: Ditën kritike kemi qenë duke shkuar në një të pame me personat e lartë cekur dhe nuk e kam parë aksidentin si ka ndodhur vetëm se F. kur na ka treguar se ndodhi një aksident dhe ka shtuar se nuk shoh mirë.

Gjykata nga deklarata e dëshmitarit Xh. F. ka vërtetuar, i cili veç tjerash ka deklaruar: Më kujtohet se ditën kritike kam shkuar te miku im në fshatin Halabak me Traktor “Forguson” dhe Ram për të ndërruar një lopë. Kam qenë duke drejtuar traktorin e që ishte duke ra shi, ka shtuar se e kam parë aksidentin nga se kur ka hyrë në tejkalim të traktorit tim kerri i Policisë, automjeti “Golf 3” ka qenë në shiritin e tij dhe goditja ka ndodhur në shiritin e Golfit në krahun e majtë dhe ka theksuar se kam qenë afër vendit të aksidentit për afërsisht në distancë 7-8 m.

Gjykata nga deklarata e dëshmitarit - i mituri L. F. ka vërtetuar, i cili veç tjerash ka deklaruar: Ditën kritike me datën 19.09.2013 jemi nisur nga shtëpia në fshatin Peran për të shkuar me Traktor dhe Ram me ndërruar një lopë në fshatin Halabak, e kemi ndërruar lopën dhe jemi nisur për në shtëpi. Jemi nisur rrugës për në fshatin Peran, unë kam qenë i ulur në Ram me shikim mbrapa. Mbrapa nesh ka qenë një kerr tjetër dhe kerri i policisë, kerri që ka qenë pas nesh ka qëndruar mbrapa nesh duke vazhduar rrugën, kurse kerri i policisë ka hyrë në tejkalim me një shpejtësi të madhe dhe nuk ka pasur mundësi të ndalet mbrapa traktorit e ka vazhduar edhe tejkalimin e traktorit dhe ka ndodhur aksidenti për afërsisht 7-8 m afër nesh.

Gjykata nga mendimi dhe konstatimi i grupit të ekspertëve Prof.Dr. N. I., Mr.Sc. M. B. dhe Msc. G. H. të dëgjuar në seancat e shqyrtimit gjyqësor të dt.26.02.2014 dhe 10.03.2014 ka vërtetuar, të cilët veç të tjerash kanë deklaruar: Edhe sot ishim në vendin e ngjarjes për t’i rikujtuar disa detaje duke pasur parasysh se ka qenë një rast mjaft i rëndë, kanë theksuar se deri te aksidenti ka ardhur në bazë të tejkalimit që e ka bërë automjeti i policisë, kurse nga drejtimi i kundërt ka qenë automjeti “Golf 3” dhe ka ndodhur aksidenti, si në figurën 4 (katër) të ekspertizës ku i kemi paraqitur 2 (dy) pozita, pra afër mesit të vijës ndarëse ka ndodhur kontakti

në shiritin e kundërt të Golfit ashtu që ana e majtë e automjetit të policisë është ndeshur në anën e majtë të automjetit "Golf". Llogaritja e shpejtësive të automjeteve të involvuara në këtë aksident është llogaritur në bazë të dy (2) metodave grafo-analitike dhe diagrami i islibarit e që janë marrë në konsideratë si provë këndet para lëvizjes së automjeteve dhe këndet pas ndeshjes. Vlerësimi pas ndeshjes është vlerësuar nga shkalla e deformitetit të automjeteve dhe pozicionit të tyre përfundimtar të marr nga skica e vendit të ngjarjes dhe rrjedhës së aksidentit në përgjithësi. Si rezultat i kësaj force goditëse natyrisht automjeti "Golf" rrotullohet rreth aksit të vet vertikal deri në pozicionin e vet përfundimtar, ndërsa automjeti "Toyota" meqenëse në fazën përfundimtare të tejkalimit pas pikës së kontaktit gjegjësisht në një kënd rreth 30 shkallë zhvendoset nga pozicioni goditjes deri në pozicionin përfundimtar. Vlerësimi i këndeve para dhe pas ndeshjes përfshirë edhe rrjedhën e aksidentit janë përdorë softuer adekuat dhe përmes simulimeve janë arritur pozicionet përfundimtare sikur në skicën e vendit të aksidentit. Pozicioni i goditjes i paraqitur në faqen 4 në këtë super ekspertizë të komunikacionit dhe i analizuar sipas simulimeve softuerike pikërisht është i bazuar edhe në dëmtimet e automjeteve dhe në bazë të këtij pozicioni të goditjes simulimet kanë treguar se pozicionet përfundimtare të automjeteve janë ato të paraqitura në skicën dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes. Çfarëdo pozicioni tjetër i goditjes nuk i përgjigjet pozicionit përfundimtar të automjeteve pas aksidentit, është ritheksuar nga grupi i ekspertëve se kontakti në mes të dy automjeteve ka ndodhur në shiritin e "Golf-it", janë analizuar të gjitha variantet për me arritur deri te pozicioni përfundimtar i dhënë nga ana e policisë, është analizuar edhe varianti kur "Golf-i" do të tërhiqet në anën e djathtë të shiritit të vet por vetëm pozicioni i dhënë me ekspertizë me simulim ju ka përgjigjur pozicioneve përfundimtare të automjeteve pas aksidentit. Grupi i ekspertëve rrjedhën e aksidentit e kanë shpjeguar në shqyrtim gjyqësor edhe përmes projektorit me CD, video-incizim përmes së cilës kanë trajtuar 3 (tri) versione të ndryshme lidhur me mundësinë e rrjedhës së aksidentit dhe 2 (dy) versione të tjera të kërkuara nga mbrojtja, kanë konstatuar se verzioni i parë i përgjigjet rrjedhës së aksidentit përfshirë pozicionet përfundimtare nga skica e vendit të aksidentit, dëmtimeve të shkaktuara në automjete dhe forca goditëse gjatë procesit të ndeshjes. Grupi i ekspertëve verzionin e dytë dhënë në CD, video-incizim (mundësia që aksidenti të ketë ndodhur në shiritin e majtë të drejtimit të lëvizjes së automjetit Golf) ka konstatuar se ky pozicion i supozuar nuk i përgjigjet rrjedhës së aksidentit, dëmtimeve të shkaktuara në automjet (posaçërisht dëmtimeve në anën e majtë të automjetit Toyota), dhe pozicioneve përfundimtare të realizuara gjatë simulimeve, gjithashtu grupi i ekspertëve ka prezantuar edhe verzionin e tretë (pozicioni pjesërisht në pankinë), kanë konstatuar se nuk i përgjigjet rrjedhës së aksidentit sepse pozicionet përfundimtare në këtë rast do të ishin krejtësisht të kundërta si në skicën e vendit të aksidentit. Grupi i ekspertëve ka shtuar se pas vizitës në vendin ku kanë qenë automjetet e ekspozuara (në Stacionin Policor në Fushë Kosovë), kemi bërë vlerësimin e dëmeve dhe deformimet që kanë pësuar të dy automjetet, me ç'rast është konstatuar se deformimet në automjetin "Toyota" kanë qenë më të vogla krejtësisht në anën e majtë, ndërsa deformimet në automjetin "Golf" kanë qenë shumë të mëdha, gjithashtu në anën e majtë të tij, krejtësisht ka qenë i deformuar dhe si shkak i kësaj kanë qenë edhe pasojat shumë të mëdha, ngase automjeti "Golf" ka qenë krejtësisht jashtë përdorimit dhe jo funksional.

Dëshmitari D. B. zyrtar policor në njësinë e hetimeve të trafikut në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Ditën e aksidentit kemi marr informatën rreth orës 16:25 në vendin e ngjarjes kemi arritur në orën 17:10. Moti ka qenë me shi po ashtu edhe rruga ka qenë e vështirësuar edhe pse kemi përdor emergjencën, ka shtuar se pozicionet e automjeteve të aksidentuara janë gjetur si në fotografi dhe në skicën e vendit të ngjarjes. Si në skicën e vendit të ngjarjes në pikën nr.1 kemi gjetur gërvishtje në asfalt të lëna nga automjetet e aksidentuara, dhe ka shtuar se pika nr.1 nga vija e bardhë është 0.45 cm. Kufizimi i shpejtësisë në atë pjesë të rrugës është 50km/h, dhe pasi që kemi përfunduar vendin e ngjarjes të dy veturat i kemi konfiskuar dhe i kemi dërguar në Stacionin e Trafikut në Fushë Kosovë dhe më pastaj



ekzaminimin e këtyre automjeteve i kanë bërë ekspertët me urdhër të prokurorisë, ku personalisht në pjesën e përfundme (poshtme) nuk kam parë diçka që ka mbetur në automjetet në njërin apo tjetrin.

Nga ekspertizat mjeko-ligjore të dt.11.11.2013 për 5 (pesë) të lënduarit nga eksperti mjeko-ligjor Dr. N. U., gjykata ka vërtetuar se si pasojë e aksidentit të komunikacionit e dëmtuara S. H., ka pësuar ndrydhje me gjakderdhje trurore në regjionin bazal ballor me prani të ajrit, thyerje multifragmentare depresive e kockës së përparme të anës së djathtë të kokës me ndryshime në regjionin naso-orbito-ethmoidal plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e gjurit të djathtë. I dëmtuari F.H. ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin e gjoksit dhe mushkërive, ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës, prezencë e gjakut në hapësirën e lirë të krahavorit të anës së djathtë, thyerje e humerusit (kockës së mbi bërrylit) të djathtë, thyerje serike e brinjëve nga I – IV pa dislokim fragmentar, ndrydhje dhe paralizë e nervit radial të anës së djathtë, thyerje e pjesës distale të kockës oss radii të anës së djathtë, nxjerrje e dhëmbit d21. I dëmtuari S.A. ka pësuar ndrydhje me gjakderdhje trurore minimale në regjionin fronto-bazal të anës së djathtë, prezenca e ajrit të lirë, thyerje e kockës së hundës, thyerje e kockave të maksilles të dy anëve, prezencë e pjesërishme e ajrit të lirë në hapësirën e lirë të djathtë të gjoksit, ndrydhje me gjakderdhje brenda mushkërore në anën e djathtë, thyerje e kapakut të gjurit të majtë dhe për tre të dëmtuarit e lart cekur lëndimet janë shkaktuar nga veprimi mekanik të mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë) të cilat lëndime klasifikohen në lëndime të rënda trupore. Kurse i dëmtuari A.Ç. ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin e qafës, gjoksit dhe regjionin brenda shpatullave si dhe regjionin ijoro kërbishtor dhe i dëmtuari A. G. ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin ijoro kërbishtor, lëndimet janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë) dhe për të dy të dëmtuarit e lart cekur, lëndimet e tilla klasifikohen në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

Nga raportet e autopsisë të dt.24.09.2013 për të ndjerit S.H. dhe M. H. gjykata ka vërtetuar se si shkak i vdekjes së të ndjerëve ka ardhur si pasojë e lëndimeve të rënda të organeve vitale të pësuar nga ky aksident komunikacioni.

Nga super ekspertiza e dt.18.10.2013 gjykata ka vërtetuar se aksidenti ka ndodhur gjatë veprimit të tejkalimit të një automjeti dhe traktori nga ana e drejtuesit të automjetit “Toyota Land Cruiser” me ç’rast në pa mundësi të rimarrjes së shiritit të tij paraprak të lëvizjes dhe realizimit të plotë të tejkalimit automjeti “Toyota Land Cruiser” përplasjet me automjetin “VW Golf” i cili ishte duke lëvizur në shiritin e tij qarkullues në kahje të kundërt me automjetin “Toyota Land Cruiser”. Automjeti “Toyota Land Cruiser” me pjesën e përparme ballore të majtë të automjetit të tij përplasjet në pjesën e përparme ballore të majtë të automjetit “VW Golf” (si në fig.4). Pozicioni i goditjes ndërmjet automjeteve “Toyota Land Cruiser” dhe “VW Golf” i paraqitur (në fig.4) i përgjigjet dëmtimeve të këtyre automjeteve të cilat vërehen nga fotografitë prezente në dokumentacionin e aksidentit (fig.5). Pas qastit të goditjes me automjetin “VW Golf” automjeti “Toyota Land Cruiser” vazhdon lëvizjen në mënyrë të pa kontrolluar duke pësuar rrotacion ndaj aksit vertikal nga ana e djathtë (shiqar në drejtimin paraprak të lëvizjes së tij) me ç’rast ndalet në pozicionin rreth 11 m nga pozicioni i përafërt i goditjes. Automjeti “VW Golf” pas qastit të goditjes ndalet në afërsi të pozicionit të goditjes duke pësuar rrotacion rreth aksit vertikal për një kënd prej rreth 140° (fig.6). Rrjedha teknike e aksidentit e analizuar përmes simulimeve softuerike (fig.3,4 dhe 6) i përgjigjet të dhënave faktike të aksidentit dhe rrjedhës së aksidentit në rastin konkret. Shpejtësia e lëvizjes së automjetit “VW Golf” në qastin e paraqitjes së rrezikut sipas llogarive grafo-analitike ka rezultuar të jetë rreth 83[km/h]. Shpejtësia e lëvizjes së automjetit “VW Golf” në qastin e paraqitjes së rrezikut po ashtu është përcaktuar në bazë të gjatësisë së hedhjes së farit të djathtë dhe softuerit (fig.10) me ç’rast ka rezultuar të jetë rreth 84[km/h]. Shpejtësia e lëvizjes së automjetit “Toyota Land Cruiser” në qastin e paraqitjes së rrezikut sipas llogarive grafo-analitike ka rezultuar të jetë rreth 97[km/h]. Duke u bazuar në analizën dhe konstatimet lidhur me këtë aksident grupi i ekspertëve ka dhënë

mendimin përfundimtar se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të drejtuesit të automjetit “Toyota Land Cruiser” i cili ka ndërmarr veprimin e tejkalimit pa u siguruar se rruga ka hapësirë të mjaftueshme për realizimin e plotë të tejkalimit (duke pasur parasysh distancën dhe shpejtësinë ndaj automjetit nga kahu i kundërt). Ka drejtuar automjetin e tij me shpejtësi prej rreth 97 km/h e cila është më e madhe se shpejtësia e lejuar për pjesën e rrugës në të cilën ka ndodhur aksidenti.

Nga konstatimi dhe mendimi mbi ekzaminimin e automjeteve të aksidentuara, grupi i ekspertëve Prof.Dr.N. I., Prof.Dr.M. B. dhe Dr.Sc.N. L. prof.asoc, me dt.07.10.2013 gjykata ka vërtetuar se automjetet “Toyota” dhe “Golf III” nga aspekti teknik kanë qenë në gjendje të rregullt para aksidentit.

Nga skica e vendit të ngjarjes të dt.19.09.2013 dhe fotodokumentacioni gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e që përputhet me deklaratat e dëshmitarëve dhe me mendimin e grupit të ekspertëve i paraqitur me shkrim dhe dëgjimi i tyre në shqyrtimin gjyqësor lidhur me rrjedhën e aksidentit të automjeteve të aksidentuara deri në pozicionet e tyre përfundimtare.

Nga CD-ja me video-incizim e prezantuar nga grupi i ekspertëve në shqyrtim gjyqësor përmes projektorit, lidhur me rrjedhën e aksidentit, gjykata vërtetoi se verzioni i parë i përgjigjet rrjedhës së aksidentit bazuar në pozicionet përfundimtare të automjeteve të aksidentuara, nga skica e vendit të aksidentit, dëmtimet e shkaktuara në automjete dhe forca goditëse gjatë procesit të ndeshjes.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plotë deklaratave të dëmtuarve - dëshmitarëve, F.H. dhe S. A., e posaçërisht nga deklaratat e dëshmitarëve A.Sh., F.Sh., Xh. F. dhe L. F., nga të cilat u vërtetua se i akuzuari ditën kritike ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit me një shpejtësi të madhe të një automjeti dhe një traktori të cilët qarkullonin para tij, ka dalë në shiritin e kundërt dhe në pamundësi të rimarrjes së shiritit të tij paraprak shkaktonte aksident komunikacioni duke e goditur automjetin e tipit “Golf III” në shiritin e tij.

Po ashtu gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u vërtetua nga konstatimi dhe mendimi i grupit të ekspertëve të cilët me metoda shkencore duke u bazuar në skicën dhe fotografitë e vendit të ngjarjes të cilët kanë theksuar se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të drejtuesit të automjetit “Toyota Land Cruiser”, i cili ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit pa u siguruar se rruga ka hapësirë të mjaftueshme për realizimin e plotë të tejkalimit (duke pasur parasysh distancën dhe shpejtësinë ndaj automjetit nga kahu i kundërt), dhe ka drejtuar automjetin e tij me shpejtësi prej rreth 97 km/h, e cila është më e madhe se shpejtësia e lejuar në atë rrugë në të cilën ka ndodhur aksidenti.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, i cili nuk ka lëvizur me shpejtësi adekuate e cila i lejon shoferit që të kontrollojë mjetin, në kushte ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht duke pasur parasysh pamjen, dukshmërinë e rrugës, ngarkesën e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit në mënyrë që mjetin e vet ta ndal para çdo pengese me çka ka shkel nenin 54 par 1 të LSKRR, dhe po ashtu ka ndërmarr veprimin e tejkalimit në hapësirë të pa mjaftueshme për realizimin e plotë të tejkalimit, duke pasur parasysh diferencën ndërmjet shpejtësisë së tij dhe të mjetit që do të tejkalohej si dhe distancën dhe shpejtësinë ndaj mjeteve që vijnë nga krahu i kundërt që të bëjë veprimin e tejkalimit pa i penguar dhe rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacionin rrugor në kundërshtim me nenin 71 par. 1 të LSKRR, me shkeljen e këtyre neneve të lartcekura përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, duke mos i kushtuar vëmendje të mjaftueshme shpejtësisë në vendbanim, për t'iu përshtatur kushteve në rrugë, dhe ndërmarrjes së veprimit të tejkalimit në hapësirë të pa mjaftueshme, për çka edhe është shkaktuar aksidenti.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata kërkesën e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarve të familjes H. av.A. Q. për caktimin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të palëve të dëmtuara e ka refuzuar me arsyetim se do ta zvarriste në mënyrë të konsiderueshme këtë çështje penale dhe palët e dëmtuara pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material me datë 19.11.2013, me numër të lëndës C.nr.605/2013.

Gjykata nuk ia fali besimin deklaratës së dëshmitarit D. B. duke e vlerësuar në kundërshtim me provat tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor, lidhur me gërvishtjen në rrugë apo piken e goditjes.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit në mënyrë të hollësishme analizoi mbrojtjen e të akuzuarit të ushtruar nga mbrojtësi i tij av.M. H..

Mbrojtësi i të akuzuarit i cili ka kërkuar që edhe një herë të shqyrtohet propozimi që të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes, gjykata këtë propozim e ka refuzuar në shqyrtimin gjyqësor që të dilet në vendin e ngjarjes, ngase konsideron se është e panevojshme dhe e tepërt dhe ky propozim është bërë me qëllim të zvarritjes së procedurës penale, po ashtu është refuzuar edhe propozimi i mbrojtjes për kryerjen e një ekspertize të re, me pretendimet e mbrojtjes se ekspertiza e kryer nga ekspertët e Fakultetit të Inxhinierisë - Dega e Komunikacionit, ka të meta të natyrës profesionale në veçanti nga pamundësia e ekspertëve të përcaktojnë pikën e kontaktit fizik në mes të dy automjeteve, e po ashtu është kërkuar që të angazhohet një ekspert i cili do të bëjë shikimin e dy automjeteve për të vërejtur gjurmët e mundshme në pjesën e fundme të tyre.

Gjykata propozimet e mbrojtjes i ka refuzuar si të pabazuara dhe në kundërshtim me provat e shqyrtuara dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ngase konsideron se grupi i ekspertëve i përbërë nga Prof. Dr. N. I., Mr.Sc. M. B. dhe Msc. G. H. të cilët e kanë kryer super-ekspertizën janë nga Institucioni publik - Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike-Departamenti i Komunikacionit, të cilët janë ligjërues në këtë fakultet, duke i vlerësuar mjaft kompetent dhe të thirrur për të kryer ekspertiza të kësaj natyre, e që konsideron se pretendimet e mbrojtjes lidhur me pikën e kontaktit apo pikën goditëse, grupi i ekspertëve në Super-ekspertizën me shkrim dhe në shqyrtimet gjyqësore, përmes metodave shkencore e duke u bazuar në skicën dhe fotografitë e vendit të ngjarjes e kanë sqaruar shumë qartë dhe bindës rrjedhën e aksidentit dhe pikën goditëse *duke theksuar se pozicioni i goditjes ndërmjet automjeteve "Toyota Land Cruiser" dhe "VW Golf III" ka qenë afër mesit të rrugës në shiritin e automjetit "VW Golf III" si në fig.4 të Super-ekspertizës*, dhe nuk ka pasur kundërthënie në mes ekspertëve. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi ligjore në kuptim të nenit 141 par. 1 KPPRK-së, të kërkojnë nga prokurori i shtetit që të paraqes kërkesë për ekspertizë që është relevante për mbrojtjen e tij dhe par. 2 i këtij neni ka paraparë se i pandehuri mund të

paguaj vetë për ekspertizë dhe t'i dorëzohet prokurorit të shtetit, këtë mundësi ligjore e kanë pasur nga koha e kryerjes së veprës penale, dhe këto propozime të mbrojtjes tani gjykata i ka vlerësuar se bëhen për ta zvarritur procedurën, po ashtu grupi tjetër i ekspertëve që vijë nga i njëjti fakultet i përbërë nga Prof.Dr. N. I., Prof. Dr. M. B. dhe Dr.Sc. N. L. prof. asoc. kanë kryer ekzaminimin e automjeteve të aksidentuara, të cilët kanë dhënë mendimin se nga aspekti teknik të dy automjetet kanë qenë në gjendje të rregullt para aksidentit.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka shprehur keqardhje duke ju kërkuar falje familjes H. për të ndjerit. Po ashtu rrethanat familjare për të akuzuarin gjykata i ka vlerësuar se është prind i katër (4) fëmijëve, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Rrethanë rënduese gjykata gjeti peshën e rëndë të veprës penale të shkaktuar nga veprimet e të akuzuarit, që ka rezultuar me dy vëllezër të vdekur dhe tre persona me lëndime të rënda trupore dhe dy me lëndime të lehta trupore, rrethanë tjetër rënduese gjykata e ka vlerësuar tejkalimin e kufizimit të shpejtësisë duke drejtuar automjetin zyrtar me shpejtësi prej 97 km/h në vendbanim ku kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes është 50 km/h dhe ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit të një automjeti dhe një traktori me ram, me çka e ka rrezikuar trafikun publik duke shkaktuar aksident komunikacioni, rrethanë tjetër është se i njëjti ka qenë i gjykuar edhe më parë me dënim me gjobë për veprën penale nga neni 252 par.1 të KPK-së, që ka të bëjë me energji elektrike. Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimit. Kjo gjykatë konsideron se aksidentet e komunikacionit me pasoja fatale në vendin tonë janë në rritje dhe dënimet e shqiptuara në këto raste duhet të jenë në proporcion me shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjkata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme që të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, e që janë të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit është marrë me aktvendim të posaçëm, P.nr.969/13, dt.17.03.2014 dhe arsyet janë dhënë në këtë vendim në kuptim të nenit 367 par. 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë në bazë të nenit 62 dhe 68 par.1,2,3 dhe 4 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL  
P.nr.969/13, dt.17.03.2014**

**Sekretarja Juridike  
Mihrie Sheholli**

---

**Gjyqtari i vetëm gjykues  
Gazmend Bahtiri**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.